

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR “Djath i Ziem Veleçiku”

DATE 04.06.2021


Sot, në datën 04.06.2021, u vendos themelimi i një shoqërie bashkëpunimi bujqësor e emërtuar Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor “Djath i Ziem Veleçiku”. Kjo shoqëri do të realizojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin.

Kjo shoqëri u krijua me vullnetin e plotë dhe të lirë të anëtarëve të saj:

1. **Prel Hasanaj**, atësia Kol, i datëlindjes 05-04-1958, lindur në Hotë, identifikuar me letërnjoftim me nr. personal **F80405042C**;
2. **Zef Marku**, atësia Gjergj, i datëlindjes 01-10-1961, lindur në Hotë, identifikuar me letërnjoftimin me nr. personal **G11001054M**;
3. **Luçe Hasanaj**, atësia Mirash, e datëlindjes 25-01-1968, lindur në Zagore, identifikuar me letërnjoftim me nr. personal **G85125050D**;
4. **Gjeto Deshkaj**, atësia Rrok, i datëlindjes 01-04-1963, lindur në Kushe Hot, identifikuar me letërnjoftim me nr. personal **G30401083O**;
5. **Arben Hasanaj**, atësia Zef, i datëlindjes 08-05-1976, lindur në Hot, identifikuar me letërnjoftim me nr. personal **H60508037H**;
6. **Gjon Hasanaj**, atësia Prel, i datëlindjes 30-08-1999 lindur në Hot, identifikuar me letërnjoftim me nr. personal **J90830036I**;
7. **Gjovalin Hasanaj**, atësia Prel, i datëlindjes 27-08-1990, lindur në Hot, identifikuar me letërnjoftimin me nr. personal **J00827046O**.
8. **Lenë Frangaj**, atësia Nikoll, i datëlindjes 10-09-1962, lindur në Bzhete, Shkoder, identifikuar me letërnjoftimin me nr. personal **G25910040I**.
9. **Françesk Hasanaj**, atësia Gjergj, i datëlindjes 20-02-1992, lindur në Hot, identifikuar me letërnjoftimin me nr. personal **J20220049K**.
10. **Gjok Celaj**, atësia Zef, i datëlindjes 16-10-1965, lindur në Hotë, Shkodër, identifikuar me letërnjoftimin me nr. personal **G51016025J**.

NENI 1– EMËRTIMI

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë do të jetë **Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor “Djath i Ziem Veleçiku”**.



NENI 2 – FORMA

- 2.1 Shoqëria “**Djath i Ziem Veleçiku**” themelohet në formën e shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.
- 2.2 Shoqëria vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi, kryesisht Ligjit nr.38/2012 Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor dhe dispozitave përkatëse në Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

NENI 3 – SELIA


- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: “**Lagjia Grykë, Fshati Hot, Njesia Administrative Kastrat, Malësi e Madhe, K.P. 4306, Shkodër, Shqipëri**”
- 3.2 Veprimtaria e Shoqërisë do të shtrihet në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër dhe kudo tjetër ku ndodhet anëtarësia e saj.

NENI 4 – OBJEKTI

- 4.1 Objekti i veprimtarisë së ShBB konsiston në kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara më poshtë:
 - A. *Prodhimi dhe tregtimi i djathit të zier sipas traditës së zonës.*
 - B. *Bashkëpunimit si grup fermerësh me shoqatat e shoqërisë civile dhe projektet mbështetëse të skemave kombëtare e ndërkombëtare. Ofrimi i shërbimeve mbështetëse për proceset e prodhimit të djathit të zier për përmirësimin e prodhimit dhe krijimin e kushteve optimale për prodhim.*
 - C. *Rritje e prodhimit të produkteve të tjera të djathit në kushte sa më cilësore dhe kapjen e tregut me etiketën e zonës autoktone.*
 - D. *Zhvillimi i agroturizmit me produktet bio të prodhuara në këtë zonë.*
 - E. *Rritja e nivelit ekonomik të fermerëve që punojnë me djathin e zier.*

NENI 5 – KOHËZGJATJA

- 5.1 Shoqëria themelohet me një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 5.2 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.



2

NENI 6 – KAPITALI I SHOQËRISË DHE KONTRIBUTET

6.1. Kapitali i Shoqërisë është 100,000 ALL (njëqind mijë lekë), i ndarë në 10 pjesë të zotëruara nga anëtarët themelues në masën:

Prel Hasanaj	10%	10000 lekë	1 pjesë/kuotë
Zef Marku	10%	10000 lekë	1 pjesë/kuotë
Luçe Hasanaj	10%	10000 lekë	1 pjesë/kuotë
Gjeto Deshkaj	10%	10000 lekë	1 pjesë/kuotë
Arben Hasanaj	10%	10000 lekë	1 pjesë/kuotë
Gjon Hasanaj	10%	10000 lekë	1 pjesë/kuotë
Gjovalin Hasanaj	10%	10000 lekë	1 pjesë/kuotë
Lenë Frangaj	10%	10000 lekë	1 pjesë/kuotë
Françesk Hasanaj	10%	10000 lekë	1 pjesë/kuotë
Gjok Celaj	10%	10000 lekë	1 pjesë/kuotë

6.2 Kontributet në natyrë shprehen në vlerë ekonomike mbi bazë të një raporti vlerësimi të bërë nga një ekspert.

6.3 Anëtarët janë zotëruar të pjesëve sipas vlerës së kontributit të tyre në kapital.

NENI 7 – TRANSFERIMI DHE NDRYSHIMI I KAPITALIT

7.1 Pjesët e kapitalit mund të fitohen/transferohen sipas parashikimeve të ligjit 38/2012 dhe dispozitave të Statutit të SHBB.


7.2 Ndryshimi i kapitalit nuk mund të jetë në asnjë rast më i vogël se kapitali minimal.

NENI 8 – ORGANET E SHBB

Organet e Shoqërive të Bahkëpunimit bujqësor janë Asambleja e Përgjithshme dhe Administratori.

8.1 Asambleja e Përgjithshme është organ vendimmarrës dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e Shoqërisë. Kompetencat dhe mënyra e funksionimit të saj parashikohen në Statutin e ShBB-së.

8.2 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose disa persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Administratori/ët do të qëndrojnë/në në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pese) vjeçare, me mundësi rizgjedhje.





8.3 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha të drejtat dhe kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 26 të Ligjit nr.38/2012 “Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor” dhe në çdo rast në kufijtë e tagrave që i/u janë dhënë nga ligji, statuti dhe/ose akti i emërimit Shoqërisë.

8.4 Caktohet administrator i parë i Shoqërisë për një periudhë 5-vjeçare me të drejtë rizgjedhje:

Z. Gjon Hasanaj, shtetas shqiptar, i datëlindjes 30-08-1999, lindur në Hot, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J908300361.

Specimeni i firmës së Administratorit të parë të Shoqërisë është si më poshtë:

Emër Mbiemër 	Nënshkrimi 
---	---

8.5 Administratori ose çdo person i autorizuar prej tij paraqitet pranë QKB për të bërë regjistrimin e Shoqërisë.

NENI 9 – GJUHA

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 11 (njëmbëdhjetë) kopje në gjuhën shqipe.

NENI 10 – DISPOZITA TË FUNDIT

10.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt - Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

10.2 Ky akt themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të ShBB-së pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.




Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor “Djath i Ziem Veleçiku”




ANËTARËT THEMELUES:




PREL HASANAJ

ZEF MARKU

LUÇE HASANAJ

GJETO DESHKAJ

Gjeto Deshkaj

[Handwritten signature]

GJOVALIN HASANAJ

Gjovalin Hasanaj

[Handwritten signature]

GJOK CELAJ

Gjok Celaj

[Handwritten signature]

ARBEN HASANAJ

Arben HASANAJ

[Handwritten signature]

GJON HASANAJ

Gjon Hasanaj

[Handwritten signature]

LENË FRANGAJ

Lenë Frangaj

[Handwritten signature]

FRANÇESK HASANAJ

FRANÇESK Hasanaj

[Handwritten signature]